




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI	Nr. Prot. 06-690/20
Dep. DPKI	Br. Prot. 06-690/20
Nr. i faq. 02	Data 05-03-2020
Broj stranic	Datum 05-03-2020
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.03.2020, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-2854/19*, për zyrtarin e lartë z. Shefqet Osmani, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPKI-06-2854/19*, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Shefqet Osmani, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtuftjeshëm: Agjencia), sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Shefqet Osmani, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Podujevës, i njëjti ishte si Person i Autorizuar në biznesin privat “Newco SeK-Kos Industrial Zone” SH.P.K. Përmes shkresës zyrtare, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtuftjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-2388-1/19), rezulton se zyrtari i lartë z. Shefqet Osmani është pronar dhe person i autorizuar në biznesin në fjalë.



Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Shefqet Osmani për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-2854/19, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese, me kërkesë të zyrtarit të lartë, Agjencia ka organizuar dhe mbajtur një takim brenda ambienteve të saj, ku i njëjti është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë edhe Person i Autorizuar në biznesin privat, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, dhe si e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Shefqet Osmani është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-528/20), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Shefqet Osmani ka bërë ndryshimet e kërkuara dhe i njëjti nuk figuron më të jetë Person i Autorizuar në biznesin privat “Newco SeK-Kos Industrial Zone” SH.P.K.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Shefqet Osmani, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, duke u tërhequr nga pozita e Personit të Autorizuar në biznesin në fjalë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

